

VENDIM
Nr.885, datë 22.12.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR NË PROJEKTIN “SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA, KAVAJË II”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar në projektin “Shkarkimi i ujërave të zeza, Kavajë II”, me një shumë financimi 5 500 000 (pesë milionë e pesëqind mijë) euro.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2003

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,
në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, referuar bisedimeve qeveritare të datës 25 nëntor 2003,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi me vlef të prej gjithsej deri 5 500 000 euro (me fjalë: pesë milionë e pesëqind mijë euro) për projektin “Shkarkimi i ujërave të zeza, Kavajë II”.

2. Po të merren vesh Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau shuma të tjera financimi për përgatitjen ose për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të përfundohet ndërmjet

Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësit të shumës së financimit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontrata përkatëse për financim nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2011.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ajo vetë nuk është marrësja e shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendime eventuale lidhur me shlyerjen që mund të lindin në bazë të kontratës për financim, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Qeveria e Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e shumës së financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më datë 22 dhjetor 2004 në dy origjinalë secili në gjuhën gjermane dhe atë shqipe, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Anastas Angjeli

Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë

Hans Peter Annen